



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT**  
**MINISTRI**

MIRATOHET

**SOKOL OLLDASHI**  
MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT

**U D H Ë Z I M**

**Nr. 24, datë 20.10.2010**

**PËR PËRCAKTIMIN E NJË PËRKUFIZIMI TË PËRBASHKËT  
TË PJESËVE KRITIKE TË ZONAVE KUFIZUESE TË SIGURISË  
NË AEROPORTE**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, Ligjit Nr.10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë” dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9658, datë 18/12/2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes Shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Europian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjes dhe Hercegovines, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohëshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Për Krijimin e një Zonë të Përbashkët Aviacionit Europian,

## **UDHËZOJ:**

### **Neni 1**

1. Në aeroportet, ku më tepër se 40 anëtare të stafit mbajnë karta identifikimi të aeroportit që u japin akses për në zonat kufizuese të sigurisë, pjesët kritike të zonave kufizuese të sigurisë do të jenë si më poshtë:
  - a) çdo pjesë e aeroportit në të cilën pasagjerët që nisen kanë akses pas kontrollit, përfshirë dhe bagazhet e kabinave të tyre;
  - b) çdo pjesë e aeroportit përmes së cilës, pas kontrollit përmes ekranit, mund të kalojnë ose mund të mbahen bagazhet e dorës që do të transportohen, nëse bagazhi nuk është siguruar.
2. Për qëllime të paragrafit 1, çdo pjesë e aeroportit do të përkufizohet si pjesë kritike e zonave kufizuese të sigurisë për sa kohë që:
  - a) pasagjerët që nisen, duke përfshirë bagazhet e kabinave të tyre, pasi janë kontrolluar, janë prezentë në atë pjesë;
  - b) bagazhi i dorës që do të transportohet, pasi është kontrolluar, kalon ose mbahet në atë zonë, nëse nuk është i siguruar.
3. Për qëllime të paragrafeve 1 dhe 2, autobuzi i avionit, mjeti që transporton bagazhet apo mjete të tjera të transportit ose kalimi për këmbësorët do të përkufizohen si pjesë e aeroportit.

### **Neni 2**

Për qëllime të këtij Udhezimi “Bagazh i siguruar” do të quhet bagazhi i dorës i kontrolluar që do të udhëtojë fizikisht i mbrojtur me qëllim që të parandalojë futjen e ndonjë artikulli të ndaluar.

### **Neni 3**

Në aeroportet ku më tepër se 40 anëtarë të stafit mbajnë karta identifikimi të aeroportit që u japin akses për në zonat kufizuese të sigurisë, Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të vazhdojë të identifikojnë pjesët kritike të zonave kufizuese të sigurisë në përputhje me “Programin Kombëtar të Sigurisë së aviacionit civil” dhe legjislacionin në fuqi që rregullon fushën e sigurisë në aviacionin civil.

### **Neni 4**

I gjithë stafi, përfshirë edhe ekuipazhin e fluturimit dhe pajisjet që ata mbajnë, duhet të kontrollohen në ekran përpara se t’u lejohej hyrja në pjesët e referuara në pikën (a) të nenit 1(1), kudo që këto përbëjnë pjesë të ndërtesës së terminalit.

### **Neni 5**

Kur bagazhi i siguruar kontrollohet nga stafi jo përmes ekranit, duhet të merren masa për t’u siguruar që një bagazh i tillë nuk është ngacmuar apo ngatërruar me dicka tjetër përpara se të futet në avion.

### **Neni 6**

1. Duke përjashtuar Nenin 4, stafi nuk do të ketë nevojë të kontrollohet përpara se t’i lejohej hyrja në pjesët kritike të zonave kufizuese të sigurisë të një aeroporti me kusht që, ata të jenë gjatë gjithë kohës të shoqëruar nga një staf i autorizuar dhe të kontrolluar.

Eskorta do të jetë përgjegjëse për çdo thyerje të sigurisë që mund të ndodhi nga anëtarët e stafit që po shoqërohen.

2. Duke përjashtuar Nenin 4, anëtarët e stafit, të kontrolluar në ekran, që përkohësisht largohen nga pjesët kritike të zonave kufizuese të sigurisë, nuk është e nevojshme të kontrollohen pas kthimit të tyre me kusht që, ata të kenë qenë gjatë gjithë kohës nën vëzhgim konstant të mjaftueshëm për t’u siguruar që ata nuk kanë futur sende të ndaluara në pjesët kritike të zonave kufizuese të sigurisë.

### **Neni 7**

Pa cënuar Nenin 6, në çdo rast që persona të pakontrolluar mund të kenë akses në pjesët kritike të zonave kufizuese të sigurisë, në këto zona duhet të bëhet një kontroll i plotë sigurie.

### **Neni 8**

Ky Udhezim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare